



## Ftesë për Aplikim në Raundin e 7-të të

### Skemës së Celulës së të Rinjve, Programi i BE-së për bursa post-diplomike 2010

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European (ZKNE) në Prishtinë dhe Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritet Evropian (AKZHE) në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, shpallin hapjen e konkursit për Raundin e 7-të të Skemës së Celulës së të Rinjve, programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovë i cili është duke u zbatuar nga SOFRECO SA. Aplikimi është i hapur nga **11 janar 2010 deri më 26 shkurt 2010** dhe kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të aplikojnë për **Programe Master** në universitete të shteteve anëtare të BE-së. Programi i Bursave, **gjuha e punës e së cilës është gjuha angleze**, do të ofroj deri në 42 bursa të plota (numri real i bursave të ofruara mund të jetë më i vogël varësisht nga përshtatshmëria e kandidatëve dhe fondet në dispozicion). Kjo ftesë do të jetë e hapur për studentët e diplomuar në fakultetet si juridik, ekonomik apo/edhe menaxhment, shkencë politike, art dhe literaturë, inxhinieri, gjeologji, veterinar, biologji, nutricion, kimi apo ndonjë fushë tjetër akademike (siç është specifikuar në Rregullat e Procedurës) që është në përputhje me sektorët e specializimit në vijim:

- ◇ **Juridik (Përafrimi i legjisllacionit, të drejtat intelektuale, komerciale dhe industriale, Legjisllacioni i BE-së për transport)** – deri në 13 bursa në dispozicion
- ◇ **Makroekonomi dhe Financa Publike** – deri në 15 bursa në dispozicion
- ◇ **Veterinari, Fitosanitari dhe Siguria e Ushqimit** – deri në 6 bursa në dispozicion
- ◇ **Energji, Mjedis dhe Miniera** – deri në 4 bursa në dispozicion
- ◇ **Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore** – deri në 4 bursa në dispozicion

Të drejtë konkurrimi kanë kandidatët të cilët:

- ◇ Posedojnë letërnjoftim dhe/apo Dokument të Udhëtimit të UNMIK-ut të vlefshme apo letërnjoftim të lëshuar nga Autoritetet e Kosovës apo pasaporta e Kosovës
- ◇ Janë të diplomuar në njërin nga fushat e lartpërmendura. Studentët të cilët janë në përfundim të studimeve poashtu kanë të drejtë konkurrimi **nëse marrin diplomën jo më vonë se 30 qershor 2010**.
- ◇ Flasin rrjedhshëm gjuhën angleze dhe shqipe apo serbe. Njohja e gjuhëve tjera të BE-së do të konsiderohet përparësi.
- ◇ Disponueshmëria për udhëtim nga shtatori 2010
- ◇ Janë të lindur më **27 shkurt 1970** apo më vonë

Bursat do të mbulojnë shpenzimet, për më së shumti, **42 bursistë**, si në vijim:

- ◇ Shpenzimet e shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës
- ◇ Shpenzimet e vizës
- ◇ Sigurimin shëndetësor
- ◇ Biletat e udhëtimit
- ◇ Testin e gjuhës Angleze IELTS

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të zotohen të:

- ◇ Punojnë për Qeverinë e Kosovës (apo Universitetet Publike apo organe tjera sipas marrëveshjes) si praktikant së paku dy muaj para nisjes
- ◇ Ndjekin Programin e Trajnimit të Gjuhës SCR (ku është e nevojshme)
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike
- ◇ Përbushin obligimin e punësimit trevjeçar të pandërprerë në Administratën Publike të Kosovës, pas kthimit

Përzgjedhja do të zhvillohet në tri faza të cilat përfshijnë:

- ◇ Përzgjedhja e CV-ve dhe Letrave të Motivimit
- ◇ Testet me shkrim (i gjuhës Angleze, i njohurive të përgjithshme për BE-në, vlerësimi verbal dhe numerik)
- ◇ Intervistimi nga paneli i përbër nga akademik nga universitetet evropiane dhe përfaqësuesve nga ZKNE dhe AKZHEI

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit dhe dokumentet tjera përcjellëse mund të shkarkohen nga interneti, në webfaqen vijuese [www.ycskosovo.eu](http://www.ycskosovo.eu) deri më 26 shkurt 2010. Informatat shtesë mbi **rregullat e Skemës, Procedurat dhe Kriteret e përzgjedhjes gjithashtu do të jenë në dispozicion online dhe duhet të lexohen dhe të kuptohen para se të dorëzohet aplikacioni.**

Aplikuesit duhet të plotësojnë **formularin e aplikimit SCR** në **gjuhën angleze, në formatin e CV-së Euro pass**, dhe **Letrën e Motivimit** e cila duhet të jetë e datuar dhe nënshkruar me shpjegimin pse dëshironi të merrni pjesë në Skemë. Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten **kopjet e certifikuara të diplomave apo titujve të fituar** dhe **Dokumenti i Udhëtimit të Kosovës apo UNMIK-ut dhe/apo letërnjoftimi i lëshuar nga Autoritetet e Kosovës apo UNMIK-ut apo ndonjë dëshmi e vendbanimit në Kosovë apo Pasaporta e Kosovës**. Kandidatët të cilët janë **në përfundim të studimeve**, aplikacionit duhet t'i bashkëngjiesin **kopjen e transkriptit të notave dhe një deklaratë të përgatitur nga vetë kandidati lidhur me datën e pritjes të diplomimit**. Sigurohuni që të shënoni në **formularin e aplikimit SCR** dhe në **CV-në Europass një e-mail adresë të VLEFSHME dhe numër telefoni**. **Formati i CV-së Euro pass dhe formulari i aplikimit SCR** mund të shkarkohen nga [www.ycskosovo.eu](http://www.ycskosovo.eu) duke u regjistruar në webfaqe (nën faqen "Raundi VII – Ftesa për Aplikim 2010").

**NB: Aplikacionet jo të plota dhe aplikacionet që nuk përfshijnë CV-të në formatin Europass nuk do të shqyrtohen!**

Afati për aplikim: **26 shkurt 2010, deri në ora 16:45**

*Ju lutem të mos bëni kërkesa të drejtpërdrejta lidhur me aplikacionin tuaj.  
Kandidatët që **nuk kontaktohen deri më 5 mars 2010** nuk kanë arritur të hyjnë në listë të ngushtë.*

Për më shumë informata mund të konsultoni [www.ycskosovo.eu](http://www.ycskosovo.eu) apo shkruani në e-mailin [info@ycskosovo.eu](mailto:info@ycskosovo.eu)

*Vërejtje: Zbatimi i këtij programi varet nga mundësia e financimit nga BE, menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian në Kosovë*

*“Skema e Bursave të BE-së – Raundi VII” është projekt i financuar nga BE, menaxhuar nga ZNKE dhe zbatuar nga SOFRECO SA.*

